



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8106

Tirane, date 15/12/2015

Drejtuar: Z.ISUF UKPERAJ
SHOQERIA "VLLAZERIA MINERALS ALBANIA" SH.P.K
RRUGA "SHESHI RILINDJA", KOMPLEKSI "KARL TOPIA"
KULLA NR.2, KATI I DYTE,

TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1492 date 25.08.2010.

I nderuar z. Ukperaj,

Shoqëria "Vllazeria Minerals Albania" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1492 date 25.08.2010, për mineral kromi ne objektin "Livadhi i Kokës", Has, ne Qarkun Kukës.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.8307 date 14.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6134 date 15.09.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1492 date 25.08.2010, për mineral kromi ne objektin "Livadhi i Kokës", Has, ne Qarkun Kukës, për arsye se është ndërprere puna pa njoftuar me pare strukturat përgjegjëse siç është përcaktuar ne germën "d" dhe germën "dh" te nenit 18 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germen “c” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa me sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1492 datë 25.08.2010, për mineral kromi në objektin “Livadhi i Kokës”, Has, në Qarkun Kukës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1492 datë 25.08.2010, për mineral kromi në objektin “Livadhi i Kokës”, Has, në Qarkun Kukës.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

